

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVES AGENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCJA ANTIV KORUPCJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPE/DMP</u> Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	Nr. Prot. Prot. No <u>03-4246/13</u> Data Datum <u>10.12.2013</u> Date
PREHTINE	

Nr. 427-05 /12

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE, me gjykatesen Vjollca Buzhala e me procesmbajtesen Melihate Shaipi ne proceduren kundervajttese kunder te pandehur Naser Berisha nga Prizreni , per shkak te kundevajtjes nga neni 5 , 6, par.1 .3 dhe nenin 9 te Ligjit nr. 04/ L- 050, per deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtareve te larte publik , dhe deklarimin , prejardhjen , dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar sakncionuar ne baze te nenit 17 par. 1 . 3 te Ligjit te lart cekur , e ne kuptim te nenit 195 te LMK-se me dt. 3.12.2013 mori kete

AKTVENDIM

I pandehuri Naser Berisha nga i ati Jashar i lindur me 1967 në fshtin Leskovec, tani me vendbanim ne rr`` Xhevat Berisha `` pa nr. me kombesi shqiptar, i martuar , baba i 4 femijve ka te kryer fakultetin i gjendjes se mesme ekonomike.

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse i pandehurine cilsine e asamblistit komunal , nuk ka bere deklarimin e pasurise ne afatin e regullte ligjor deri me dt. 31.03.2012 ,deklarim sipas kerkeses se agjencionit , deklarim i cili i obligon te gjithë zyrtaret e larte publik që pasurinë e tyre ta deklarohen regullisht për qdo vit ,sipas kerkeses se AKK – nuk ka permbushur këtë obligimin ligjor mbrenda afatit .

-me te cilin veprim ka kryer kundervajtjen nga neni 5 , 6, par.1 .3 dhe nenin 9 te Ligjit nr. 04/ L- 050, per deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtareve te larte publik , dhe deklarimin , prejardhjen , dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar sakncionuar ne baze te nenit 17 par. 1 . 3 te Ligjit te lart cekur , e per kete

DENOHET

Me gjobe prej 200 euro / dyqindeuro /,

I pandehuri obligohet qe gjoben e shqiptuar te paguan ne afat prej 15 dite, nga dita e plotfusqishmerise se ketij aktvendimi ne te kunderten do te zevendesohet me denim burgimi duke llogaritur 20 euro me nje dite , poashtu I pandehuri obligohet qe ne afat te lartecekur te paguan 5 euro ne emer te paushallit gjyqesor, nen kercnim te egzekutimit te dhunshem.

Arsyetim

Sipas kerkeses se Agjencionit antikorupcion ne Prishtine, me nr. 01- 1887/ 2012 te dt. 24.05.2012 eshte ngritur procedura kundervajttese kunder te pandehurit Naser Berisha nga Prizeni - asambleist ne ansamblen Komunale ne Prizren per shkak te kundervajtjes nga neni i lartecekur ne dispozitiv te aktvendimit.

I pandehuri ne seancen verbale te dates 22.11.2013 ne tersi ka pranuar kundervajtjen e cila I ngarkohet ne barre duke theksuar se zorti Ibrahim Krasniqi na i ka dorzuar formularet e vjeter e qe kete formular e kame derguar perms postes ne agjencionit antikurupcion por per fat te keq e kame deklaruar me vonese . Gjykates si prove material I prezentoj vertetimin e agjencionit kunderkurrupcion te dates 23.07.2012.

Para marrjes ne pyetje te te pandehurit ne cilsu te deshmitarit eshte degjuar zyrtari I agjencionit kunderkorrupcion - Agron Behrani , nga gjyqtari Zejnullah Gashi , i cili ka theksuar se ne fillim te muajit mars agjencia kunder korrupcionit ka shprenda njoftimin per te gjithë zyrtaret kontaktus permes imejlit dhe nga ata ka kerkuar qe ti njoftoi te gjithë zyrtaret e larte publik per procesin e deklarimit te pasurise.

Deshmitari Ibrahim Krasniqi si shefi i sherbimit profesional ne deklaraten e dhene ne gjykate me date 29.10.2013 theksoi : une ne cilsine e kordinatorit per sherbime profesionale deklaroi se ne mbledhjen e komitetit dhe financa ne te cilin ka qene present edhe Naser Berisha eshte kerkuar nga ana e kryesiusit te Kuvendit qe te njoftohen per obligimin e plotsimit te formularit – deklarates vjetore te pasurise per vitin 2012, une iu kame shprendare antareve te Kuvendit formularet te cilet une I kame poseduar keshtu qe i njehti me kohe e ka pranuar (formularin e vjeter) ,mirpo tek une nuk e ka dorzuar - nuk e ka kthuar te plotsuar

Gjendja faktike e pershkruar me persëfermi si ne dispozitiv të ketij aktvendimi është vertetuar permes deklarates se te pandehurit , deklarates se zyrtarit te larte per antikorrupsion , deshmitarit Ibrahim Krasniqi - shef I sherbimit profesional , listes distributive te dt. 01.03.2012. si dhe me administrimin e provave tjera ne shkresat e lendes .

Deklaraten mbrotjese te te pandehurit se e kame bere deklarimin me kohe gjykata e vlersoi por nga ky vertetim konstatoi se deklarimin i njehti e ka bere me date 23.07.2012. – me vonese , keshtu qe te njehtin arsyetim e ka hudhur poshte si të pabazuar , nuk ia fali besimin nga se i njehti ka per qellim ti ik pergjegjeise juridiko kundervjatese , besimin ia fali zyrtarit te larte antikorrupsion Agron Behrami , deshmitarit Ibrahim Krasniqi , te pandehurin e shpalli pergjegjes dhe e denoi me gjobe me bindje se edhe me kete lloj denimi do të arrihet qellimi I duhur ndëshkimor , qe në të ardhmen mos të kryej kundervajtje të tilla apo të ngjashme.

Gjate caktimit te denimit jane vleresuar rrethanat nen te cilat eshte kryer kundervajtja, pesha e kundervajtjes te kryer dhe pasojat e saja shkalla e pergjegjesise, rrethanat materijale te pandehurit , e si rrethane lehtesuese ne kuptim te nenit 7 te LMK_se eshte mare ajo se i pandehuri per here te pare eshte paraqitur ne gjykate per kesolloj te kundervajtjes, ka bere deklarimin e pasurise me dt. 23.07.2012, ndihej i penduar , andaj dhe ne vend te denimit me burg ia shqiptoi denimin me gjobe me bindje se edhe me nje denim te tille do te arihet qellimi I deminit qe ne te ardhmen nuk do te kryeje vepra te tilla apo te ngjashme

Lartesija e shpenzimeve te procedures eshte caktuar ne baze te nenit 109 te LMK.

Nga sa u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE

Nr. 472-05 / 2012

Procesmbajtesja

Melihate Shaipi

te dt. 3.12.2013

Gjykatesi

Vjollca Buzhala

UDHEZIMI JURIDIK : Kunder ketij aktvendimi e ne afat prej 8 ditesh nga dorezimi mund te ushtrohet ankese Gjykates se Apelit ne Prishtine Divizioni per Kundervajtje , permes kesaj gjykate pa taksa.